



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e katwrt e K.K-së,s, e cila do të mbahet më **28.04.2022** (e enjte) duke filluar në ora **10:00h.**


R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Raporti tremujor financiar Janar – Mars 2022;
3. Bartja e mjeteve nga të hyrave vetanake të vitit 2021;
4. Pruarja e vendimit për ratifikimin e marrëveshjes së bashkpunimit në mes të Komunës dhe Hidromoraves;
5. Anulimi i vendimit i aprovuar me 27.12.2018 me nr.protokoli 01-7 të datës 10.01.2019, “Kryetari i Komunës të mos ndaj subvencione pa vendim të Kuvendit”;
6. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne Sallen e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 20.04.2022
Në: Novobërdë

zonj.Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 31.03.2022, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj. Mirjana Simijonovic, zv. Kryesuesi i Kuvendit zt. Ramush Mehmeti, Nënkryetari i Komunës zt. Svetislav Ivanovic, antarët e Kuvendit: Ivana Ivanovic, Stefan Kovacevic, Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Violeta Milosevic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Vlora Vllasaliu, Abdyl Gashi, Ivica Cenic, Drejtori i Financave zt. Milos Denic, Drejtori i Sherbimeve Publike zt. Gafurr Vllasaliu, Drejtori i Administratës Serboljub Djokic, përfaqësuesi i OSBE-së Edmond Hyseni, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit e cila pasi pershendeti të gjithë të pranishmi tha: konstatoj korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Pruarja e vendimit për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore për transfer dhe subvencione për ndihmë momentale personave fizik dhe juridik;
3. Shqyrtimi i draft Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane;
4. Pruerja e pajtueshmerisë për dhënjën e vendgjahishtës në teritorin e Komunës së Novobërdës;
5. Raporti i punës nga Kompania Ecohigiena;
6. Të ndryshme.

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtohen më këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Pasi nuk pati propozime shtesë aprovohet njëzëri rendi i ditës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: kërkoj nga Kryesuesja dhe zv. Kryesuesi që të jenë më transparent në publikimin e ndryshimeve të cilat ndodhin në Kuvend, andaj paraqes shqetësimin tim se përse nuk është vendosur emri im në ëeb faqe të Komunës në listen e asambleisteve. Gjithashtu e kam edhe një vërejtje se përse nuk publikohet statuti dhe rregullorja dhe vendimet në ëeb faqe. Vërejtja tjetër që e kam, mbledhja e tretë e imja është dhe emrin dhe mbiemrin juridikisht nuk e kam të shënuar në rregull, pasi që nuk e kam një mbiemer por i kam dy mbiemra në dokumentacionin tim, ju faleminderit. Kryesuesja tha: do ti marim parasysh këto rekomandime tuaj por keni mundur ti fusni te pika të ndryshme.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar e Kuvendit.

Pika e dytë: Pruarja e vendimit për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore për transfer dhe subvencione për ndihmë momentale personave fizik dhe juridik;

Për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave zt.Milos Denic.

Milos Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: gjatë pregaditjes së buxhetit që ta plotësojm grandin nga viti i kaluar, këtë shumën prej 11,000€ e kemi bartur në grandin e Drejtorisë së Arsimit në sektorin e Subvencioneve, pra qëllimi ka qenë që këto mjete mos ti humbin në vitin e kaluar, ndërsa këtë vit në mënyrë që ti shfrytëzojm këto mjete pra mos ti humbin na duhet një vendim i Kuvendit Komunal në mënyrë që ti shfrytëzojm këto mjete sipas rregullores së brendshme që e kemi për ndihmë njerëzve në nevoj, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: unë nuk po e kam të qarë se a po bëhet fjalë për buxhetin e vitin 2022 apo 2021?, Kuvendi Komunal nuk ka rregullore për ndarje të subvencioneve pasi që vet Kuvendi e ka anuluar atë rregullore, andaj ne së pari duhet të aprovojm rregulloren e pastaj ta marrim një vendim të tillë, nese ka kërkesa të qytetarëve dhe Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit që të ndaj ndihma për persona juridik është në rregull perndryshe ne sot nuk kemi të drejtë që të marrim një vendim të tillë, ju faleminderit.

Milos Denic tha: buxheti është i vitit 2022 i pregaditur në vitin 2021 në shtator dhe e kemi rregulloren për ndarjen e ndihmave dhe subvencioneve.

Pranvera Kastrati Gashi tha: kërkoj nga Drejtoria e Financave pas hapjes së transfereve që bëjë njoftimin publik të aplikimit të personave me nevoj dhe të caktohen kriteret e aplikimit për mjete financiare, gjithashtu të caktohet shuma e përkrahjes.

Ramush Mehmeti tha: Drejtor kërkoj që ta shpjegosh se për çka ne po marrim vendim, a po i marrim nga një kod po i bartim në tjetrin apo për çka po marrim vendim, nuk është i qartë vendimi, kur ta marrim një vendim duhet të jetë në pajtim me ligjin, unë jam për nuk jam kunder, vetem kërkoj që vendimi të jetë i qartë, nese ne marim një vendim në kundërshtim me ligjin po votojm kunder vetvetes.

Selatin Nuhiiu pasi pershendeti të pranishmit tha: unë mendoj se Drejtori i Financave e ka me vend këtë kërkesë pasi që këto mjete janë nga të hyrat vetanake dhe besoj që është e nevojshme që të ndahen këto mjete, po besoj që çdo gjë është në rregull dhe Drejtori është shumë i qartë.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: besoj se kjo metod e din edhe zv.Kryesusi pasi që patëm marrë vendim që mos me u nda mjete pa vendim të Kuvendit pasi që e konsiderojshum se po keqperdoren, pra pasi që është ende e njëjta rregullore besoj që së pari duhet të ndrrohet. Unë nuk jam që këto mjete të barten pasi që mendoj se këto mjete duhet të shfrytëzohen për bursa të studentave dhe nxënësve.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 14vota për, 1 kunder (Abdyl Gashi) aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Aprovohet vendimit për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore për transfer dhe subvencione për ndihmë momentale personave fizik dhe juridik.

Pika e tretë: Shqyrtimi i draft Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane;

Kryesuesja tha: duhet ta japim një pajtueshmeri që kjo Rregullore të dal në debate publike dhe procedura të mëtutjeshme, besoj se e keni marrë materialin me kohë dhe keni pasur kohë që ta analizoni se për çfarë bëhet fjalë më gjerësishtë.

Ramush Mehmeti tha: është mirë që po diskutohet kjo Rregullore por unë edhe më heret kam reaguar dhe po reagoj përseri, problemi është i mos shpendarjes së materialit në kopje fizike, antarët e Kuvendit në

mënyrë që ta analizojn një draft Rregullore duhet ta marrin materialin me kohë në kopje fizike, unë nuk e kam lexuar dhe nuk e komentoj.

Abdyl Gashi tha: besoj se edhe komisioni më herët e ka kryer këtë punë dhe mendoj se dikush nga ekzekutivi ish duhur që të na njoftoj se prej ku vazhdohet dhe si vazhdohet. Jemi e vetmja Komunë që nuk e kemi bërë emërimin e rrugëve e që është kushtë për integrimin në institucionet ndërkombëtare, unë plotësisht pajtohem vetëm kërkoj që të bëhet një punë e mirë që të ketë edhe njoftime në lagje, në fshatra, në mënyrë që të kemi të përfshir sa më shumë banorë.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri kjo pikë nga antarët e Kuvendit dhe mirret ky:

PELQIM

APROVOHET pelqimi për fillimin e procedurave për plotësim ndryshim të draf Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane;

Pika e katërt: Prerja e pajtueshmerisë për dhënjen e vendgjahishtës në teritorin e Komunës së Novobërdës;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Bujqësisë Slllobodan Savic.

Slllobodan Savic pasi pershendeti të pranishmit tha: do të mundohem të sqaroj se çka konkretisht po kërkojmë, kemi që një kohë të gjatë problem me qytetarët e në anen tjetër e kemi një vlerësim të inspeksionit për pylltari të viti 2017, ku inspeksioni na ka ndaluar aktivitetin e gjuetis në Komunën e Novobërdës deri sa mos të zgjidhet problemi i vendgjahishtës, deri sa mos të caktohet zona se ku mundën gjuetarët me vepru. E kemi edhe vendimin e Drejtorëve të mëhershëm, drejtorit të inspeksionit që e ka ndaluar gjuetinë, mirëpo fatkeqësisht kem gjuetar të pandergjegjshëm që dalin dhe gjuajnë, nga Ministria e Bujqësisë e kemi pajtueshmerinë që ta caktojm vendgjahishten në teritorin e Komunës, por nuk mundemi ta shpallim tenderin publik, nuk mundë të veprojm pa e pasur edhe pajtueshmerin nga Kuvendi, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi tha: pasi e keni pru vendimin në vitin 2017 për ndalimin e dy vendgjuetive në Komunën e Novobërdës, është duhur që ta bini edhe vendimin të cilin e ka falsifikuar ish Kryetari i mëhershëm, prej momentit që dy vengjueti i keni bërë në një vendgjueti dhe për këtë sigurisht keni inicuar procedur të tenderit për dhënje me qira kishte qenë mirë të sillni edhe vendimin e Ministrisë së Bujqësisë se pse e anuloi tenderin.

Slllobodan Savic tha: e kemi pajtueshmerin e Ministrisë që të kemi një vendgjahishte në teritorin e Komunës së Novobërdës.

Ramush Mehmeti tha: pika është e qëlluar që ka ardh në Kuvend por unë e kam një pyetje, a ka marrë vendim Kuvendi Komunal pasi që është kompetent për themelimin e vendgjuetive, por pas formimi të vendgjuetis duhet ta kemi të qartë pasi që Kuvendi formon një komision i cili është kompetent për marrjen e vendimit dhe shpalljes së tenderit për dhënje në shfrytëzim, pajtohem plotësisht por vetëm kërkoj që e gjitha të shkoj në harmoni me ligjin.

Kryesuesja tha: ne vetëm duhet që të dhëjmë pajtueshmeri që të ndalohet gjuetia ilegale, ne si Kuvend duhet të dhëjmë pajtueshmeri dhe besoj se do të njoftohemi për të gjitha procedurat e mëtutjeshme.

Slllobodan Savic tha: Drejtoria e Bujqësisë nuk e formon komisionin, Kryetari ose Kuvendi do ta formoj komisionin.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 14vota për, 1 përmbajtur nga anëtarët prezent të kuvendit aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

PAJTUESHMERI

APROVOHET Pajtueshmeria për themelimin e vendgjuetisë së Përbashkët në Komunën e Novobërdës.

Pika e pestë: Raporti i punës nga Kompania Ecohigiena;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Menaxherit të EccoHigienes Naser Ibrahimit.

Naser Ibrahimit pasi pershendeti të pranishmit tha: ne e kemi marrëveshjen me Komunën e Novobërdës prej 2010 për menaxhimin e teritorit të kësaj Komune dhe me atë marrëveshje prej Kuvendit jemi duke operuar dhe për çdo vit kemi një aneks kontratë. Unë e kam pregaditur një raport të cilin ju e keni marrë me material. Ne në sistem kemi gjithësej 1056 ekonomi familjare dhe 104 biznese dhe institucione komunale, gjithashtu kemi familje me raste sociale dhe invalid të luftes që nuk paguajne. Gjithashtu e kam bërë një pershkrim se sa faturime vjetore kemi për 1 vit, faturime për amvisëri i kemi 63,360€, faturime mujore për biznese 20,904€, faturimi për shkollë është 4,650€, faturimi për ambulanta është 2,609€, Faturimi i objekteve Komunale është 1800€, gjithsej faturim vjetor kemi 94,184€. Inkasimin mujor për amvisëri dhe biznese e kemi 58,883.58€, inkasimi mujor për shkollë është 4,650.72€. Inkasimi mujor për Ambulanta 2,609.28, inkasimi nga objektet komunale 2,800€, inkasimi nga PTK, gjykata Ministria e Punës si dhe e Burgut 3,044.16€. Shpenzimet vjetore në paga janë 36,980, shpenzimet e deponisë 12,782€, Derivate dhe naftë 11,567€, Mirëmbajtja e makinerisë Servisimit 5,260€, Fakturimi 6,000€. Në fund e kemi edhe orarin e punës këtu se si veprojmë në Komunën e Novobërdës, kompania operon për çdo ditë në fshatrat të ndarë duke e përfshirë të gjithë teritorin e Komunës së Novobërdës. Ne i kemi pasur dy kamion por janë jashtë përdorimit, tash është edhe një informat e mirë pasi që na kanë blerë një kamion dhe prej të hënës dalim në terren. Gjithashtu na ka kaluar edhe një projekt që e kemi pregadit në bashkpunim me Kryetarin në mandatin e kaluar dhe besoj se shumë shpejt do të na sjellin kontinjera të rinjë, ky ishte një informim i shkurtër nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: po bëhet një deponi shumë e madhe prej fshatit Stanishor a mundemi të bëjmë diçka për pastrimin e këtyre deponive?.

Naser Ibrahimit tha: organizata GIZ që tri vite radhazi është duke identifikuar deponit ilegale në Komunën e Novobërdës, janë evidentuar 88 deponi ilegale. Në javën e kaluar ka qenë Drejtori i Kompanisë dhe kemi arritur një marrëveshje që prej Stanishorit deri në Bostan, kompania me i pagu puntorët si dhe restorantet në Makresh kanë shprehur dëshirë që të participojnë në mënyrë që të eliminohet deponia.

Abdyl Gashi tha: e kam një pyetje në lidhje me teritorin e Kalasë për arsye se aty nuk gjendet asnjë kontinjër edhe pse vizitohet shumë?, gjithashtu të mirëmbajtja e kamioneve that se dy kamion nuk i keni pasur në përdorim atëherë çka keni servisuar?.

Naser Ibrahimit tha: tre kontinjër janë të kalaja dhe në çdo herë i pastrojmë prej mbeturinave, shpenzimet të kamioni ne e kemi një kamion që na ka dhënë kompania në shfrytëzim dhe ne e mirëmbajmë atë kamion.

Stojan Stanojević pasi pershendeti të pranishmit tha: materialin e kemi marrë vetëm në gjuhen shqipe.

Naser Ibrahimit tha: është e vërtetë se materialin e kemi dorëzuar vetëm në gjuhen shqipe por mendoj se Kuvendi e ka përkthyesin e vet dhe duhet të përkthehet.

Ramush Mehmeti tha: Novobërda duhet me qenë krenare me këtë Kompani që ka dhënë rezultate, unë ju përgëzoj për punën që jeni duke bërë, e di që keni vështësi dhe e di se nuk mundeni me qenë 100% efikase por edhe njëherë ju përgëzoj.

Abdyl Gashi tha: a keni bashkpunim me tregun e kafshëve në Llabjan ku pothuajse ndotet për çdo ditë dhe Komuna nuk bën asnjë veprim.

Naser Ibrahimit tha: tregun e ka tjetër kush për obligim, ne vetëm i marrim mbeturinat, ndërsa me pastru tregun nuk e pastrojmë.

Pika e gjashtë: Të ndryshme.

Kryesuesja tha: administrata e Kuvendit e ka marrë një kërkesë EësterUnion që të vazhdojë kontratën me Komunën, administrata e komunës i ka shqyrtuar kërkesën dhe kërkesa i plotëson të gjitha kushtet, këtë

pikë gjithashtu e kam diskutuar edhe me Kryetarin e Komunës dhe Kryetari ka kërkuar që ti ipet kjo pajtueshmeri.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë kërkesë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo kërkesë nga antarët prezent të Kuvendit dhe mirret kjo:

P A J T U S H M E R I

BIHET KJO Pajtueshmeri, qe administrata komunale te vazhdoj me proceduren per vazhdimin e kontrates për dhenjen e hapsires ne ndertesen Komunale në shfrytëzim, në bazë të Ligjeve në fuqi.

Kryesuesja e hapi diskutimin për piken të ndryshme.

Pranvera Kastrati Gashi tha: kërkoj që të kemi vendimin për komisionet në të cilat jem zgjedhur.

Kryesuesja tha: në momentin e votimin të vendimit të komisionit ai llogaritet i vlefshum dhe vendimin mundë ta merrni në administratën Komunale.

Stojan Stanojevic tha: e dim se këtyre ditëve njerëzit po aplikojnë për subvencione dhe e dim se ka pasur parregullsi në ndarje gjatë viteve të kaluara, andaj kërkoj një raport nga Drejtori pasi ka pasur që kan marrë disa herë e disa asnjëherë ose kërkoj që të anulohen këto subvencione deri në raportim me një vendim.

Kryesuesja tha: rreth kësaj nuk e di se a kemi të drejt të votojm, por do të kërkojm në mbledhjen e ardhshme një raport se kush ka përfituar paisje bujqësore në katër vitet e fundit.

Stojan Stanojevic tha: e kemi pasur një trajnim me OSBE-n dhe na kan thënë se kemi të drejtë që të kërkojmë dhe vetem se në Kuvend mundë të shkoj si pikë asgjë nuk është në Kundershtim me ligjin.

Kryesuesja tha: në mënyrë që të sqarohemi më mirë, nuk është problem që të votojm por Kryesuesja e bënë rendin e ditës më Kryetarin e Komunës.

Selatin Nuhiu tha: kanalizimi është i prishur në fshatin Llabjan afer Xhamisë.

Kryesuesja tha: a keni paraqit kërkesë në D.SH.P?.


Selatin Nuhiu tha: qytetarët janë ankuar te unë.

Kryesuesja tha: për këtë arsye jemi këtu që ti diskutojm problemet e qytetarëve.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.


Mbledhja përfundoi në ora 11:05.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI I KOMUNËS-SKUPSTINA OPSTINE-MUNICIPAL ASSEMBLY

Na osnovu Pravilnika za Subvencije sa br. 01/2096 datum: 14.11.2012, član 6 Skupstina Opštine Novo Brdo u sednici održano datum: **27.12.2018** doneta je ova:

ODLUKA
DA
PREDSEDNIK OPSTINE NE MOZE DA VRSI PODELU SUBVENCije BEZ ODLUKE
SKUPSTINE

- I. **USVAJA SE** odluka da Predsednik Opštine od ove sednice nema pravo da dodeli subvencije bez odluke Skupštine Opštine.
- II. Ova odluka je doneta s'razlogom da Predsednik Opštine ne izvestava Skupstinu Opštine o dodeli subvencije.
- III. Odluka stupa na snagu 7 dana nakon objavljivanja u web/stranici Opštine.

Dt. 10.01.2019
U Novo Brdo



Nebojsa Arsic
Predsedavajući Skupštine

(Handwritten signature of Nebojsa Arsic)